

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ferit Osmani, kryetari i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Afrim Shala, anëtarë, me zyrtarin ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.S., nga ..., për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 252 par 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2289/2012, të datë 21.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 20.04.2018 , mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**I.** Me rastin e ankesës së të akuzuarit E.S., detyrimisht **ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2289/2012, të datë 21.12.2017, sipas të cilit të akuzuarit E.S., për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 252 par 1 të KPK, dhe refuzohet aktakuza në kuptim të nenit 363 par.1 nën par 1.3 të KPPK, lidhur me nenin 106 par. 1 pika 1.5 të KPK, lidhur me nenin 107 par.8 të KPK, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

**II.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

**III.** Ankesa e të akuzuarit E.S., tani për tani është jo lëndore.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2289/2012, të datë 21.12.2017, është shpallur fajtorë i akuzuari E.S., për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 252 par 1 të KPK, dhe i është shqiptuar vërejtja gjyqësore, me të cilën i është bërë me dije të akuzuarit se ka kryer vepër penale të dëmshme dhe të rrezikshme, e cila përbën vepër penale, dhe nëse kryen prapë ndonjë vepër tjetër penale, do ti shqiptohet sanksioni penal më i rëndë.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzetë) €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë i akuzuari E.S., për shkak të shkeljeve esenciale të diaspozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe në këtë çështje penale i akuzuari të lirohet nga akuza, pasi që nuk ka prova se ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ose të hudhet aktakuza, pasi që ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/II.nr.368/2018, dt.17.04.2018, e ka njoftuar Gjykatën e Apelit, se sa i përket ankesës së të akuzuarit E.S., e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2289/2012, të dt.21.12.2017, të aprovohet si e bazuar, ndërsa të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar, dhe ndaj të akuzuarit të merret aktgjykim refuzues në kuptim të nenit 363 par 1 nën par 1.3 të KPPK, sepse në këtë çështje penale ka ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtojë shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, vlerësoi aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 të KPP gjeti se:

- me rastin e ankesës së ushtruar kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i njëjti detyrimisht duhet të ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, në pjesën për të cilën është ushtruar ankesa, dhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPPK, kolegji i Gjykatës së Apelit, vlerëson se më aktgjykimin e kundërshtuar në këtë çështje penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Nga aktgjykimi i kundërshtuar, rezulton se i akuzuari E.S., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 252 par 1 të KPK, dhe i është shqiptuar vërejtja gjyqësore, me të cilën i është bërë me dije të akuzuarit se ka kryer vepër penale të dëmshme dhe të rrezikshme, e cila përbën vepër penale, dhe nëse kryen prapë ndonjë vepër tjetër penale, do të shqiptohet sanksioni penal më i rëndë.

Sipas ligjit të aplikueshëm, për veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, mund të shqiptohet dënimi me burgim deri në 3 (tre) vite, kurse nga shkresat e lëndës rezulton se vepra penale është kryer me datën 04.01.2012, ashtu që ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, pasi që ka kaluar dyfishi i kohës së paraparë për ndjekje penale në kuptim të nenit 107 par 8 të KPK.

Duke pasur parasysh, se afati i parashkrimit fillon nga dita kur është kryer vepra penale, rezulton se që nga koha e kryerjes së veprës penale, sikurse është e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit, rezulton se e njëjta është kryer me dt.04.01.2012, ashtu që deri në mbajtjen e seancës së kolegjit të kësaj Gjykate, kanë kaluar më shumë se 6 (gjashtë) vite, çka do të thotë se në rastin konkret kundër të akuzuarit, për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, andaj, në këtë çështje penale nuk mund të zhvillohet procedurë e mëtejme.

Meqë, në rastin konkret ka kaluar dyfishi i kohës që kërkohet sipas ligjit për parashkrimin absolut, aktgjykimi i kundërshtuar detyrimisht ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për ç'arsye ankesa e të akuzuarit E.S., tani për tani është jo lëndore.

Shpenzimet e procedurës penale konform nenit 454 par.1 të KPPK, bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 403 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.359/2018, dt.20.04.2018**

**Zyrtari Ligjor**  
**Visar Gashi**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Afrim Shala**